



TË ARDHURA QË LULËZOJNË

Investoni në fondin që vë
në lëvizje kursimet tuaja

Raport Muaji Shkurt 2022

Informacion bazë

Administrimi i Fondit	Raiffeisen Invest sh.a
Monedha	LEK
Datë Lancimi	01 Mars 2012
Vlera fillestare e kuotës	1,000
Shuma fillestare minimale	5,000
Shuma minimale pasuese	1,000

Komisionet dhe Tarifat

Tarifë në hyrje	0%
Tarifë në dalje	0%
Tarifë Administrimi në vit	Deri ne 1.15% e vleres neto te aseteve
Tarifa te tjera te vazhdueshme	Referojuni prospektit te fondit
Komisione/tarifa të vazhdueshme	1.25% per vitin 2021
Kosto për transfertë fondesh nga palë të treta	Referojuni informacionit ne deget e RBAL

Objektivi i investimit dhe profili i investitorit

Objektivi i Fondit është të maksimizojë kthimin nga investimi, duke synuar në të njëjtën kohë ruajtjen e kapitalit të investitorit dhe sigurimin e likuiditetit të nevojshëm.

Asetet e fondit janë të investuara në bono thesari dhe obligacione të emetuara ose garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

Fondi është i përshtatshëm për individë dhe subjekte juridike të cilët mendojnë se objektivi i investimit i Fondit përputhet me kërkesat dhe pritshmëritë e tyre.


Shifra e tarifave të vazhdueshme 1.25% mbështetet në shpenzimet për vitin e mbyllur më 31.12.2021. Kjo shifër mund të ndryshojë nga viti në vit. Tarifa totale e vazhdueshme nuk mund të kalojë maksimumin prej 1.4% ne vit te vlerës neto të aseteve te fondit.

Kostot e transaksioneve janë sipas kushteve të punës të palëve ndërmjetësuese dhe nuk përfshihen në llogaritjen e komisioneve dhe tarifave të vazhdueshme, por ato i ngarkohen Fondit.

Profili i Rrezikut dhe Përfitimit

Rrezik i ulët
Përfitimet tipike më të ulëta

Rrezik i lartë
Përfitimet tipike më të larta



Fondi Raiffeisen Prestigj është në kategorinë e dytë të Profilit të Rrezikut dhe Perfitimit.

Treguesi i rrezikut dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel rreziku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes të luhatshmërisë. Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa rrezik.


Ky tregues ka për qëllim tju informoje mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës së fondit. Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e rrezikut në të ardhmen.

Të dhëna për Fondin në 28.02.2022

Vlera Neto e Aseteve	48,011,027,496
Numri i investitoreve	30,030
Çmimi i Kuotes	1,580.9850
*Kthimi vjetor neto nga investimi (28.02.2021 – 28.02.2022)	2.62%

*Tarifa e administrimit dhe tarifat e tjera të vazhdueshme zbriten përpara llogaritjes së kthimit nga investimi

Struktura e portofolit të investimeve në 28 Shkurt 2022



Në kuadër të politikës së investimit të fondit Prestigj, investimet do të kryhen kryesisht në bono dhe obligacione thesari, të emtuara ose garantuara nga Qeveria shqiptare, përmes pjesëmarrjes në ankandet e tregut primar apo transaksioneve në tregun sekondar. Bonot e thesarit 12 mujore emetohen dy herë në muaj; Obligacionet 2 vjeçare një herë në muaj; 7 dhe 10 vjeçare janë me të rralla, afërsisht një herë në tre muaj. Qeveria organizon ankande të obligacioneve referencë 5 dhe 3-vjeçare me frekuencë një herë në 2 muaj për secilin maturitet.

Instrumenti

Ne % të Aseteve të Fondit

Marreveshje të Anasjellta të Riblerjes – Rev Repo	3.50%
Depozita & Llogari rrjedhese	7.86%
Bono Thesari	25.49%
Obligacione Thesari	63.15%

Strategjia e investimeve është e fokusuar në tituj të Qeverisë Shqiptare, por përveç këtyre investimeve, Fondi mban një pjesë të asetëve në depozita afatshkurtra për të plotësuar në çdo kohë nevojat për likuiditet të investitoreve.

Vlera neto e asetëve të fondit është në nivelin e LEK 48 miliardë në datë 28 Shkurt 2022.

Zhvillimet dhe ecuria e normave te interesit te titujve te Qeverise Shqiptare gjate muajit Shkurt

Konflikti mes Rusise dhe Ukraines krijoi rreziqe gjeopolitike dhe pasiguri per tregjet financiare nderkombetare gjate muajit Shkurt. Ekonomia globale do të ndikohet nga ky konflikt dhe nga sanksionet e vendosura Rusise ne shume sektore te ekonomise si edhe nga rritja e ndjeshme e inflacionit ne nivel global apo nga reagimi i bankave qendrore me politikat e tyre monetare.


Ne Shqiperi norma e inflacionit ishte 3.7%, ky trend rrites është ndikuar kryesisht nga çmimet më të larta të produkteve ushqimore, naftës dhe energjisë ne mbare boten.

Asetet e Fondit Prestigj jane te investuara vetem ne bono dhe obligacione te emetuara nga Qeveria e Republikes se Shqiperise dhe per kete arsye fondi eshte i ekspozuar ndaj ndryshimeve ne normat e interesit te ketyre titujve. Keshtu investimet e fondit nuk kane lidhje direkte me tregjet nderkombetare, por impaktohen kryesisht nga zhvillimet ne tregun e brendshem sic jane ndryshimet ne normat e interesit te titujve te Qeverise Shqiptare.

Pergjate muajit Shkurt ne tregun vendas normat e interesit te titujve te emetuar nga Qeveria Shqiptare paten pergjithesisht nje trend renes. Yield-i i Bonos se Thesarit 12-mujore rezultoi ne 1.577% duke rene me 0.02% ne krahesim me ankandin e muajit Janar. Yieldi i bonos 3 dhe 6-mujore rezultoi perkatesisht ne 0.85% dhe 1.207% duke rene perkatesisht me 0.11% dhe 0.10%.

Per sa i perket obligacioneve, ankandi i rihapur i obligacionit 2 vjeçar-i i emetuar ne LEK rezultoi ne 1.99%, duke rene me 0.08% ne krahasim me normen e ankandit paraardhes. Ankandi i obligacionit reference 3-vjeçar rezultoi ne 2.839%, duke u rritur me 0.30% krahasuar me ankandin e fundit te muajit Dhjetor. Gjithashtu u zhvillua edhe ankandi i obligacionit 15 vjeçar i cili rezultoi ne 5.84%, duke rene me 0.04% krahasuar me ankandin e fundit te muajit Nentor.

Grafiku me poshte jep nje pasqyre te ecurise se normave te interesit te bonove dhe obligacioneve te thesarit te emetuar nga Qeveria Shqiptare gjate periudhes 1-vjeçare Shkurt 2021 – Shkurt 2022. Per obligacionet reference 3 dhe 5 vjeçare jane paraqitur yields fiks te perlloragjitura nga kuotimet e kontributoreve ne fund te muajit Shkurt.




Performanca e fondit dhe ecuria e çmimit të kuotës deri ne 28 Shkurt 2022

Fondi Prestigj vijon te kete nje performace te mire, çmimi i kuotes eshte rritur me **+0.17%** gjate muajit Shkurt. **Kthimi vjetor neto per periudhen 28 Shkurt 2021 – 28 Shkurt 2022 eshte 2.62%.**

Fondi Prestigj ka te njejten strukture te portofolit te investimeve duke perqendruar investimet ne bono dhe obligacione te emetuara nga Qeveria e Republikes se Shqiperise. Per pasoje vlere e portofolit te investimit dhe norma e kthimit pesojne luhatje sa here ka ndryshime ne kushtet e tregut, sic jane ndryshime te normave te interesit te bonove / obligacioneve te emetuar nga Qeveria Shqiptare. Keshtu kur normat e interesit ne treg rriten, vlere e titujve te portofolit ulet dhe per rrjedhoje ulet dhe norma e kthimit per periudhen e kaluar. E kunderta ndodh kur normat e interesit ulen. Ne kete menyre çmimi i kuotes mund te jete i luhatshem.

Luhatshmeria eshte pjese e natyrshme e fondeve te investimit dhe eliminimi i saj eshte i pamundur, keshtu çmimi i kuotes mund edhe te bjere, jo vetem te rritet.



Kthimi vjetor historik i Fondit Raiffeisen Prestigj per çdo vit



Investoret e fondit Prestigj dhe te gjithe fondeve te administruara nga Raiffeisen Invest keshillohen te kene nje horizont sa me te gjate investimi per te perfituar nje kthim optimal nga investimi dhe ne kete menyre ne periudhe afatmesme apo afatgjate te kene mundesi te rikuperojne edhe efektet negative te krijuara afatshkurter.

Investoret inkurajohen qe te ruajne investimin e tyre duke mos ndryshuar objektivin e qendrimit ne fond te nxitur nga situata jo e zakonshme e krijuar nga pandemia globale apo konflikti gjeopolitik, sepse ne kete menyre nuk do te rrezikojne te dalin nga fondi ne momentin e gabuar per investimin e tyre.

Të dhënat per kthimin nga investimi në të shkuarën janë vetëm ilustrative dhe nuk përfaqësojnë nje premtime apo garanci per kthimin ne te ardhmen. Te gjithe shembujt e tjere numerike, jane perdorur per qellime ilustrative dhe analize te te dhenave historike, dhe nuk duhen perdorur nga investoret per te nxjerre konkluzione per te ardhmen.

Investitorët e mundshëm duhet të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit. Raiffeisen Invest dhe forca shitëse e fondit nuk garantojnë nje kthim te caktuar te fondit.

Informacioni mbi çmimin e përditësuar të kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrave të Raiffeisen INVEST sha., në website www.raiffeisen-invest.al ose në degët e Raiffeisen Bank në Shqipëri.